




Democracy for Development  
Demokraci për zhvillim  
Demokratija za razvoj

# MONITORIMI I MEDIAVE GJATË MUAJIT SHTATOR

Shtator, 2023



# PËRMBAJTJA

<b>1</b>	METODOLOGJIA .....	3
<b>2</b>	TË GJETURAT KRYESORE .....	5
<b>3</b>	SHEMBUJT NË GJUHËN SHQIPE .....	6
<b>4</b>	SHEMBUJT NË GJUHËN SERBE .....	8

# MONITORIMI I MEDIAVE GJATË MUAJIT SHTATOR DHE ÇRREGULLIMET E INFORMACIONIT

## 1 Koha e monitorimit

1-30 Shtator 2023.

## 2 Fushë veprimi

Çrregullimi i informacionit në internet dhe mediat sociale: Uebfaqe, portalet online të lajmeve, Facebook, Youtube, TikTok dhe Instagram.

## 3 Mostra

Në gjuhën shqipe dhe serbe.

## 4 Qëllimi

Qëllimi i këtij raporti është monitorimi i çrregullimeve në mediat online në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe, rreth zhvillimeve/ngjarjeve që kanë ndodhur gjatë muajit shtator në Kosovë.

*Ky raport është përgatitur nga Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D) në kuadër të projektit “Mbulueshmëria dhe kuptueshmëria e çrregullimit të informacionit në Kosovë”, që mbështetet nga NDI dhe USAID në Kosovë. Përmbajtja e dokumentit është përgjegjësi e Institutit Demokraci për Zhvillim dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron qëndrimin e NDI Kosovo.*

## 2. METODOLOGJIA

Qëllimi i Institutit Demokraci për zhvillim (D4D), është identifikimi dhe luftimi i lajmeve me çrregullim të informacionit, trend ky në rritje i përhapjes së lajmeve me çrregullim të informacionit.

Instituti D4D, ka bërë monitorimin e mediave online dhe atyre sociale për të identifikuar lajmet/artikujt të cilat përmbajnë çrregullime të informacionit, përmes një platforme monitoruese, duke klasifikuar artikujt në bazë të kategorive: zhvillimet në veri; dialogu Kosovë-Serbi; gjuha e urrejtjes; dhuna online ndaj grave; ndasitë politike dhe ndikimi ndërkombëtar. Mediat online të cilat janë monitoruar përmes platformes kanë qenë mbi 100 media online vendore, të rajonit dhe ndërkombëtare, të selektuara në një platformë monitoruese. Monitorimi dhe analizimi i artikujve me çrregullim të informacionit është bërë paralelisht në dy mostra: në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe.

Përzgjedhja e shembujve nga të dyja mostrat është bërë duke u bazuar në përmbajtjen e artikullit i cili ka shpërndarë: dezinformata, manipulim të fakteve, përmbajtje të paverifikuara, lajm të pavërtetë, teori konspirative, clickbait, gjuhë të urrejtjes, gjuhë ofenduese, gjuhë kërcënuese, nxitëse, artikuj me tituj tendencioz, dhe raportim të njëanshëm. Kategoria më e shprehura në të dyja gjuhët është zhvillimet në veri. Në mostrën në gjuhën shqipe vërehet dukshëm edhe në grafikë dominimi i lajmeve në lidhje me ngjarjet e 24 tetorit, lidur me zhvillimet në veri. Mediat televizive kanë pasur më shumë kujdes gjatë raportimeve kur edhe po zhvillohej operacioni në Banjskë. Megjithatë, tek mediat online dhe portalet e ndryshme ka pasur një valë shpërndarje të fotografive që supozonin se ishin marrë gjatë sulmeve në veri. Nga rreth 1000 lajme të monitoruara në gjuhën shqipe, 90 artikuj kanë rezultuar me çrregullim të informacionit. Sa i përket mostrës në gjuhën serbe, nga rreth 500 artikuj të monitoruar, rreth 60 prej tyre kanë rezultuar me çrregullim të informacionit.

### 3. TË GJETURAT KRYESORE

- Gjatë monitorimit të lajmeve në mostrën në gjuhën serbe është vërejtur një numër i madh i artikujve gjatë 14 shtatorit kur u mbajt takimi në Bruksel midis Kosovës dhe Serbisë. Përmbajtja e të cilave ishin kryesisht deklarata për shtyp mbas takimeve, ku për dështimin e dialogut fajsohej Kryeministri i Kosovës.
- Ngjarjet e 24 shtatorit kanë qenë me më shumë përmbajtje me çrregullim të informacionit, ku disa nga artikujt janë falsifikuar apo keqinterpretuar informatat të përforcuara nga figura të politikës serbe.
- Audio e keq-interpretuar, ku së pari u shpërnda nga Presidenti i Serbisë, e pastaj nga mediat e tjera. Përmbajtja e audio-inçizimit ishte marrë nga radio e policisë së Kosovës, e cila u përkthye në gjuhën serbe ka pasur shtimin e fjalëve. Përdorimi i audio-inçizimit në kohë tensioni kontribon në shpërndarjen e dezinformatave dhe në nxitjen ndër-etnike, me qëllim të lëkundjes së stabilitetit brenda vendit.
- Gjetje tjetër nga mostra e gjuhës serbe ka pasur edhe shpërndarje të teorive konspirative kryesisht nga figurat politike. Kjo bëhej nga portretizimi i situatës si një kryengritje e komunitetit serb ndaj regjimit të Kurtit. Shpërndarja e këtyre narrativave nga figurat politike Serbe arrijnë të ndikojnë te komuniteti me përkatësi serbe në veri të Kosovës.
- Ngjarjet në Banjskë- në mostrën në gjuhën shqipe kanë dominuar atikuj dhe reportime në lidhje me sulmin në Banjskë, ku mediat televizive në përgjithësi kanë treguar kujdes gjatë reportimeve dhe publikimeve të informatave, ndërsa mediat online kanë publikuar informacione të paverifikuara dhe kanë shpërndarë dezinformata. Mediat online kryesisht kanë shpërndarë fotografi dhe video të marra nga vende dhe ngjarje të mëparshme, dhe janë raportuar përdorur si informata në lidhje ngjarjen e 24 shtatorit në Banjskë.
- Gjuha e urrejtjes vazhdon të jetë prezente në fjalimet dhe komentet e figurave publike, të cilët përdorin gjuhë të urrejtjes në rrjetet sociale kundrejt kundërshtarëve politik.

## 4. SHEMBUJ NË GJUHËN SHQIPE



Gazeta Aktuale ka postuar disa fotografi ne rrjetin social Facebook, ku në to shihen trupa të ushtarëve të vrarë me mbishkrimin në fotografi si: **“Terroristi serb i shtrirë në tokën dardane”** dhe një tjetër me përshkrimin : **Foto ekskluzive: edhe një terrorist serb i vranë në veri, gjenden dy trupat e tyre**”. Pas verifikimit të D4D, fotot ku shihen dy trupa të vrarë, nuk janë imazhe nga zhvillimet në veri por njëri ilustrim është gjatë luftës Rusi – Ukrainë dhe imazhi tjetër ushtarë i vrarë në Nagorno-Karabakh. Fotografitë e shpërndara janë imazhe të marra nga një kontekst tjetër të cilat në kohë tensionesh kur përdoren janë më të besueshme dhe marrin vëmendje.




Portali Drenica News ka shpërndarë një video ku shihen disa polic duke shoqëruar një person të arrestuar me mbishkrimin **“Pamje nga terroristi i zene nga Policia e Kosovës”**. Pas verifikimit ku mjafton vetëm të pahezohet video dhe vërehet qartë se emblema e policit në pamje nuk i përket Policisë së Kosovës. Mirëpo, pas nje hulumtimi në Google del se logoja në të cilën shihet silueta e një luani, i përket Policisë së Bullgarisë. Postimi bërë nga Drenica News paraqet dezinformatë dhe ka kontribuar ne intensifikimin e çrregullimt të informacionit gjatë tensioneve në Kosovë. Postimi ne Facebook ka mbledhur 862 ndërveprime, ku prej tyre 652 janë pëlqime, 37 komente dhe 173 shpërndaje.



Zëvendëskryeministrja e Kosovës, Emilija Redžepi ka postuar një fotografi që paraqet ndërtesën e komunës në Sarajevë, e cila është e ndriçuar me flamurin e Kosovës. Pas verifikimit nga D4D është vërtetuar se kjo nuk është e vërtetë dhe se fotografia është e montuar. Kjo fotografi është bërë virale në të gjitha rrjetet sociale, duke u shpërndarë nga përdoruesit shqiptarë të këtyre rrjeteve.

Fotografia në fjalë, e shpërndarë nga znj. Redžepi, hyn në kategorinë e keq-informimit (misinformation) ku përmbajtjet e fotografive shpërndahen pa u verifikuar paraprakisht. Ky postim në Facebook ka mbledhur 232 ndërveprime, ku prej tyre janë 215 pëlqime, 10 komente dhe 7 shpërndarje.

## 6. SHEMBUJ NË GJUHËN SERBE



Artikulli i postuar nga portali Kosovo Online tregon nje audio-inçizim nga radio e policisë së Kosovës, ku përkthehet “...edhe nëse vdes nuk ka asgjë”. Pas verifikimit, përkthimi i audio-inçizimit është i shtrembëruar, audio është e shkurtër dhe nuk dëgjohet as edhe një fjali e plotë të jetë thënë nga polici kosovar. Fjala është shtuar nga mediumi dhe shpërndarë edhe nga Presidenti Serb.

Ky postim përmban çrregullim të informacionit pasi që po shpërndan një informatë të pa verifikuar dhe jo të vërtetë me qëllim të nxitjes së ndasive ndër etnike. Artikulli në webfaqe ka grumbullaur 1235 lexues.

<https://www.kosovo-online.com/en/news/politics/audio-recording-kosovo-policemens-conversation-about-wounded-serb-even-if-he-dies>



Partia Progressive Serbe në uebfaqen e tyre kanë publikuar një artikull me titull Darko Glišić: : **KURTI është fajtori i vetëm për ngjarjet në Kosovë dhe Metohi**. Ky artikull përmbledh intervistën që Kryetari i Bordit Ekzekutiv të Partisë Progressive të Serbisë, Darko Glishiq, kishte dhënë për televizionin Happy TV i cili ka folur për ngjarjen e 24 shtatorit në fshatin Banjskë në veri të Kosovës. Më tutje artikulli thekson fjalët e Glishiq “Tragjedia që ndodhi në vendin tonë është e madhe, serbët e pafajshëm humbën jetën duke ua marrë tokën dhe shtëpitë e tyre pushtuesve mizorë që çdo vit terrorizonin serbët në veri të Kosovës dhe Metohisë.”



Duke marrë parasysh se sulmi ka ndodhur në Kosovë, lajmi në fjalë pretendon se sulmi ndodh si rezultat “i shtypjes së komunitetit serb në veri, nga regjimi i Kurtit”. Artikulli në fjalë ka shpërndarë dezinformata dhe po informon në mënyrë të gabuar qytetarët serb në Serbi. Ky artikull ka grumbulluar 1383 ndërveprime ku prej tyre 1331 pëlqime , 11 komente dhe 41 shpërndarje. Kurse intervista për televizionin Happy TV kishte grumbulluar 2928 klikime në Youtube. Deklaratat e dhëna nga Glishiq, e që u bënë lajm në serbi, Ky lajm cilësohet si dezinformatë apo përmbajtje e pa verifikuar, pasi që zyrtari serb Gliqiq ka dhënë informata të pa bazuara në fakte, në të cilat sulmuesit po viktimizohen dhe vëmendja po bartet te një narrativë që portetizon Qeverinë e Kosovës si pushtues.

<https://youtu.be/5dLQ7Z1UZzc>

Instituti Demokracia për Zhvillim (D4D) është themeluar në prill të vitit 2010 nga një grup i analistëve që po brengoseshin gjithnjë e më shumë që procesi i shtetndërtimit e kishte lënë anash demokracinë. Vizioni i D4D-së është të promovojë një qytetari aktive dhe të arsimuar, e cila merr pjesë plotësisht në hapësirën publike dhe e përdor arenën publike për përfaqësim dhe vendimmarrje për të diskutuar dhe ndërtuar konsensus për shpërndarjen e resurseve që janë efikase, të shpejta, afatgjate dhe që sjellin zhvillim të barabartë. D4D ndikon në politikat specifike, promovon një qasje ndërsektoriale për zgjidhjen e problemeve dhe trajton rutinën institucionale të vendimmarrjes duke rekomanduar përmirësime në rritje dhe operon me efektivitet maksimal në mënyrë që të promovojë plotësisht stabilizimin e Kosovës dhe zhvillimin demokratik. Për më shumë informata rreth aktiviteteve të D4D-së, ju lutemi vizitoni faqen tonë elektronike: **[www.d4d-ks.org](http://www.d4d-ks.org)**

Mbështetur nga:

